



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

**V E N D I M**

Nr. 24, datë 26.01.2021

**PËR**

**MIRATIMIN E SHTYRJES SË AFATIT TË LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN:  
“DEPOZITA BREGDETARE TË KARBURANTEVE, SHITESË KAPACITETI  
(V=84354 M<sup>3</sup>), ME VENDNDODHJE NË PORTO ROMANO, BASHKIA DURRËS**

Në mbështetje të neneve 27, 28 dhe 40, të Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.519, datë 20.09.2017 “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të subjektit zhvillues “Genklaudis” sh.a., Këshilli Kombëtar i Territorit,

**VENDOSI:**

1. Miratimin e shtyrjes së afatit të Lejes së Ndërtimit të objektit: “Depozita bregdetare të karburanteve, shtesë kapaciteti (V=84 354 m<sup>3</sup>), me vendndodhje në Porto Romano, Bashkia Durrës”, me subjekt zhvillues shoqërinë “Genklaudis” sh.a
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave miratuar me Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit Nr.18, datë 03.10.2018, nuk ndryshon.
3. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**

**EDI RAMA**



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

  
BELINDA BALLUKU



ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

  
LEDIASTOTA

